

VENDIM
Nr. 227, datë 13.4.2023

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 110, DATË 6.3.2019,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE
DHE TË RREGULLAVE TË PËRZGJEDHJES SË ORGANIZATAVE
JOFITIMPRURËSE, TË AUTORIZUARA PËR OFRIMIN E NDIHMËS JURIDIKE
PARËSORE TË GARANTUAR NGA SHTETI, QË PËRFITOJNË FINANCIME
NGA BUXHETI I SHTETIT DHE MËNYRA E FINANCIMIT TË TYRE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 15, të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 110, datë 6.3.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në shkronjën “b”, të pikës 2, fjala “...aplikuese...” zëvendësohet me fjalët “...që paraqesin kërkesën...”.

2. Në shkronjën “ç”, të pikës 4, fjala “...aplikime...” zëvendësohet me fjalët “...për paraqitjen e kërkesës për përfitimin e financimit ...”.

3. Në pikën 5 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) në shkronjën “dh”, togfjalëshi “...dorëzimit të aplikimeve...” zëvendësohet me fjalët “...paraqitjes së kërkesës për përfitimin e financimit...”;

b) në shkronjën “e”, fjala “...aplikimit...” zëvendësohet me fjalët “...kërkesës për përfitimin e financimit...”.

4. Nënndarja “iii”, e shkronjës “a”, të pikës 6, shfuqizohet.

5. Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Kërkesa për përfitimin e financimit, si dhe të gjitha dokumentet që vërtetojnë plotësimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta, që i bashkëlidhen kërkesës, paraqiten pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ia përcjell kërkesën komisionit vlerësues menjëherë.”.

6. Pas pikës 7 shtohet pika 7/1, me këtë përmbajtje:

“7/1. Komisioni vlerësues, brenda 7 (shtatë) ditëve nga administrimi i kërkesës për përfitimin e financimit, kryen veprimet e mëposhtme:

a) kur kërkesa përmban të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, sipas parashikimeve të këtij vendimi, njofton organizatën jofitimprurëse mbi vazhdimin e procedurës së verifikimit të kriterëve;

b) kur kërkesa nuk përmban të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, sipas parashikimeve të këtij vendimi, njofton organizatën jofitimprurëse për plotësimin e të metave brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit. Mosplotësimi i të metave brenda afatit përbën shkak për mospranimin e kërkesës.”.

7. Në pikën 8 bëhen këto ndryshime:

a) në shkronjën “a”, fjalët “...aplikimeve për financim të organizatave...” zëvendësohen me “...kërkesave për përfitimin e financimit të paraqitura nga organizatat...”;

b) në shkronjën “b”, fjalët “...për shkelje të qëllimshme të procedurës së shqyrtimit, të vendimeve për përzgjedhjen e organizatave jofitimprurëse të autorizuar që përfitojnë financim, si edhe të masës së financimit...” zëvendësohen me “...ndaj vendimeve të komisionit vlerësues...”.

8. Pas pikës 8 shtohet pika 8/1, me këtë përmbajtje:

“8/1. “Komisioni vlerësues dhe komisioni i ankimeve shqyrtojnë, përkatësisht, kërkesat për përfitimin e financimit dhe ankesat ndaj vendimeve të komisionit vlerësues, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative.”.

9. Shkronja “c”, e pikës 9, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) 1 (një) përfaqësues nga struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë për monitorimin e institucioneve në varësi të saj ose nga Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve.”.

10. Në pikën 10, fjala “...aplikimeve...” zëvendësohet me fjalët “...kërkesave për përfitimin e financimit...”.

11. Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“11. Komisioni vlerësues dhe komisioni i ankimit ngrihen me urdhër të ministrit të Drejtësisë jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e njoftimit të thirrjes sipas pikës 5, të këtij vendimi. Emrat e anëtarëve të komisioneve nuk bëhen publikë deri para shpalljes së rezultateve të shqyrtimit të ankesave. Anëtarët e komisioneve sipas pikave 9 dhe 10, të këtij vendimi, zgjidhen nga radhët e nëpunësve civilë.”.

12. Në pikën 14 bëhen këto ndryshime:

a) Fjala “...aplikimet...” zëvendësohet me fjalët “... kërkesat për përfitimin e financimit...”;

b) Togfjalëshi “...10 (dhjetë) ditëve...” zëvendësohet me “...sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë...”.

13. Pas pikës 14 shtohet pika 14/1, me këtë përmbajtje:

“14/1. Komisioni vlerësues vlerëson përmbushjen e kritereve të përgjithshme dhe të veçanta, bazuar në metodologjinë e miratuar me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.”.

14. Në pikën 16, fjalët “...i rezultateve për shkelje të procedurave...” shfuqizohen.

15. Në pikën 24, fjala “...revokimin...” zëvendësohet me fjalët “...dhe propozuar shfuqizimin...”.

II. Kërkesat për financim të organizatave jofitimprurëse të autorizuara, që janë depozituar pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, shqyrtohen sipas dispozitave në fuqi të vendimit në kohën e depozitimit të kërkesës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku